



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 25 Prot

Tiranë, më 08/01/2015

REKOMANDIM

Nr. 05 datë 08/01 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

KONSTATOVA:

Në zbatim të urdhrit nr. 209 datë 25/11/2014, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka ushtruar kryesisht kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me objekt;

Zbatimi nga ana e kontrolluesit e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave personale", i ndryshuar, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është kontrollues publik, objekti dhe misioni i të cilit është; "përgatitja dhe aplikimi i politikave të qeverisë në sferën ekonomike, të tregtisë dhe sipërmarrjes, për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët prioritarë të ekonomisë, konvergimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen".

Kontrolluesi si organ qendror ka në varësi disa institucione si; Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Qendra Kombëtare e Liçencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave (DPMP), Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA). Kontrolluesi funksionon mbi bazë të VKM Nr. 835, datë 18.09.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes". Institucionet e varësisë funksionojnë mbi bazë të legjislacionit përkatës për çdo fushë të veprimtarisë përgjegjëse.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, kontrolluesi mbledh, përpunon, ruan, administron të dhëna personale dhe informacion konfidencial për subjektet e të dhënave. Në këtë kuptim në cilësinë e kontrolluesit Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes mbart detyrimin për zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe akteve të nxjerra nga Komisioneri në zbatim të tij.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar ka rezultuar se kontrolluesi, mbledh, përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “individë” dhe “punonjës”.

Të dhënat personale për kategorinë e subjekteve individë, mbledhen nëpërmjet kontratave, të cilat lidhen midis kontrolluesit dhe individëve të ndryshëm, për privatizime të objekteve pronë shtetërore, kontratave të qirasë për pronën publike, si dhe gjatë trajtimit të kërkesë/ ankesave, të ndryshme që i drejtohen për zgjidhje kontrolluesit.

Të dhënat personale për kategorinë e subjekteve “punonjës”, kontrolluesi i mbledh gjatë marrëdhënieve që krijon me këto subjekte për punësim, krijimit të dosjeve të personelit, në përputhje me Kodin e Punës dhe ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim, pranë Zyrës së Komisionerit, lidhur me mbledhjen përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës.

Ky konstatim i bërë gjatë kontrollit administrativ lidhet me mos plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Kontrolluesi duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. *Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.*

Mos përditësimi i njoftimi nga ana e kontrolluesit, lidhet me mungesën e transparencës ndaj publikut në raport me subjektet e të dhënave personale. Subjektet e të dhënave personale nëpërmjet “Regjistrat Elektronik të Njoftimeve”, i cili është i hapur për publikun në faqen zyrtare www.idp.al të Zyrës së Komisionerit, kanë mundësinë të njihen me të dhënat personale që kontrolluesi përpunon, (kategoritë e të dhënave personale, mjetet e përpunimit, subjektet të cilët përpunojnë të dhënat, sigurinë e të dhënave personale etj.). Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet “Regjistrat Elektronik të Njoftimeve”, mbikëqyr dhe monitoron kontrolluesit për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Mos plotësimi i detyrimit ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, deklarimi i pasaktë apo mos përditësimi i formularit të njoftimit, bëjnë që Komisioneri të mos përmbushë qëllimin e ngarkuar në ligj.

- Kontrolluesi Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nuk ka hartuar;
 - Rregullore të veçantë, për mbledhjen përpunimin e të dhënave personale, në të cilën të përcaktohen rregulla për mbledhjen, përpunimin, sigurinë, konfidencialitetin, kohën e ruajtjes së të dhënave personale etj, detyrim që rrjedh nga neni 27, 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.
 - Rregullore për mbledhjen përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet sistemit të video regjistrimit me kamera CCTV, detyrim që rrjedh nga neni 27, i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 i Komisionerit, *përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera, i ndryshuar.*

Konstatimi i bërë në këtë rast lidhen me mos respektimin e neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 i Komisionerit, *përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera, i ndryshuar.*

Mungesa e rregullave dhe e hartimit të rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet dhe detyrimet që rrjedhin nga nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, të cilat detyrojnë kontrolluesin të marrë masa teknike dhe organizative për përcaktimin e funksioneve ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave, përcaktimin e aksesit, përcaktimi i personave të autorizuar që hyjnë në të dhënat dhe programet e ndryshme që aplikon kontrolluesi, tregojnë për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallës së ulët të konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Dokumentimi në formë të shkruar i këtyre masave tekniko-organizative dhe zbatimi i tyre në praktikë është garanci për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrolluesit.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

- Kontrolluesi Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në faqen e tij të internetit www.ekonomia.gov.al nuk ka publikuar *“politikat e privatësisë”*, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kudër të mbrojtjes së privatësisë.

Ky konstatim lidhet me detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave personale neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Publikimi i rubrikës *“politikat e privatësisë”* në faqen e internetit të kontrolluesit ka për qëllim informimin e individëve subjekte të të dhënave personale që aplikojnë online ose personave që vizitojnë/aksesojnë faqen.

Sipas përcaktimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky nen, kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit etj. Kur kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Mos realizimi i detyrimit ligjor për informim nga kontrolluesi iu mohon subjekteve të të dhënave personale të drejtën për tu informuar rreth të dhënave që ata deklarojnë pranë kontrolluesit, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale, faktin se çfarë bëhet me të dhënat personale të tyre, kush po i përpunon të dhënat personale, ku dhe kujt i përhapen të dhënat e tyre, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit Proçedurave Administrative

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në faqen tuaj në internet www.ekonomia.gov.al të publikohen në një rubrikë të veçantë "*politikat e privatësisë*", me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfaqësohen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. *(Për plotësimin e kësaj pike të Rekomandimit të mbahet parasysh Opinioni "Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat" i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare www.idp.al).*
2. Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të hartohet rregullore e veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, si dhe rregullore për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të vëzhgimit me kamera. *(Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al si dhe ofrojmë asistencën tonë).*

3. Kontrolluesi të rregullojë këndin e vëzhgimit me kamera të fasadës së ndërtesës, me qëllim shmangien e mbikëqyrjes së ambienteve publike (*trotuare, rrugë*) si dhe të vendosë tabelat informuese në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të tij, për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nëpërmjet sistemit me kamera CCTV.
4. Kryerja e këtyre detyrimeve të realizohet brenda një afati kohor prej 45(*dyzet e pesë*) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksione administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI